



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJE

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

NJESIA E PROKURIMIT

Nr. Prot.
29.06.2018

Kolonjë, më

Për: Bashkimin e operatoreve ekonomik Avdolli shpk, Vashtmia shpk dhe Rehovari shpk përfaqëses i bashkimit me prokurë të posaçme nr.3219 rep dhe nr.2251 kol datë 10.06.2018 është shoqëria Rehovari Sh.p.k me NUIS L77703001H me administrator Spiro ZOTO .

Adresa: **Avdolli shpk** Korçë, Korçë Lagjia Nr. 18, Rruga Muzakajt, Zona Kadastrale 8561, Nr. Pasurie 96 dhe **Vashtemia Shpk** Korçë, Libonik Vashtemi rruga nacionale Korçë –Pogradec Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6 dhe **Rehovari shpk** Korce Qender - Erseke REHOVE Ndertese nje kateshe, zona kadastrale 3164, numri i pasurise 630/134.

Procedura e prokurimit: **Procedura Kërkesë për Propozim PUNE me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës : **REF-71443-05-26-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: ***Kjo kontrate ka per qellim Rikonstruksion i linjes se ujesjellesit Kronjza - Rezervuaret Ujembledhes Leskovik, Bashkia Kolonje (faza e dyte -) viti 2018, ndësa kohëzgjatja e kontratës është 30 (Tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.***

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik **SARK shpk** **NIUS K52531415 H**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera **2,059,600 lekë pa Tvsh** (*Dymilionesepesëdhjetëenëntëmijëegjashtëqind*) **lekë paTvsh.**
(me numra dhe fjalë)

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik **Avdolli Shpk & Vashtemia Shpk & Rehovari shpk**
numri i NUIS **K 14721001 P** *NUIS* **J 64103054 Q** *NUIS* **L77703001H**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i Nuis-it*

Vlera **2,300,000** (*Dymilionetreqindmijë*) **lekë pa Tvsh .**
(me numra dhe fjalë)

3.Operatori Ekonomik **EGLAND shpk** **NIUS J 96829419 D**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera **1,994,720** (*Njëmilionenëntëqindenëntëdhjetëekatërmijëeshtatëqindenjëzetë*) **lekë paTvsh.**

(me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomik **SARK shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

2.Operatori Ekonomik **EGLAND shpk**

Emri i plotë i shoqërisë

NIUS K 52531415 H

numri i NIPT-it

NIUS J 96829419 D

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik SARK shpk me numer NIUS K52531415 H

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ **Për Prokurimin Publik** ”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **SARK shpk**.

a. Në shtojcën 11,kriteret e veçanta të kualifikimi **pika 1,germa g**,ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori ekonomik **SARK shpk** vërtetimin e lëshuar nga **OSHEE** për kontratën me kod FI1A020245307149 nuk e ka ne emer te operatorit ekonomik **SARK shpk**, por titullar i kontratës është **z.Arben Kajolli** , pra personi qe vertetohet qe nuk ka detyrime ndaj OSHEE është **z.Arben Kajolli** dhe jo operatori ekonomik **SARK shpk**.

Vertetimi i lëshuar nga OSHEE nuk konfirmon shlyerjen e detyrimeve te operatorit ekonomik **SARK shpk** , duke mos plotesuar “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, **pika 1 , germa (b)**.

Kjo në kundërshtim të nenit 26, pika 7,germa c të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Ndërkohë që kjo kontratë duhet të ishte në emër të përfaqësuesit ligjor sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , (i ndryshuar),

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** ofertën e

operatorit ekonomik **SARK shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

b. Në kriteret e veçanta të kualifikimi kapacitetin teknik **pika 2.3.1**, ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

*a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **1,243,750 (Njëmilionedyqindedyzetë tremijëeshtatëqindpesëdhjetë) lekë pa tvsh**, të realizuar nga operatori ekonomik gjate tri vitet e fundit.*

ose

*b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **4,975,000 (Katërmilionenëntëqindeshatatëdhjetëepesëmijë) leke pa tvsh** .*

1- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **SARK Shpk** për kontratën e paraqitur me objekt: **“Blerje materiale per riparimin e linjave të ujësjellësit Roskovec,Luar,Jagodinë ”** rezulton si mëposhtë :

a-Kontrata e dorëzuar është furnizim me materiale per riparimin e linjave të ujësjellësit dhe jo punë e ngjashme referuar akt-dorezimit të materialeve pranë Bashkisë Roskovec ,kjo në kundërshtim me kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit .

2- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **SARK Shpk** për kontratën e paraqitur me objekt: **“Punime mbrojtjeje per linjen e transmetimit Bogove-Poliçan”** rezulton si mëposhtë :

Duke verifikuar zerat e punimeve sipas situacionit perfundimtar bashkengjitur kesaj kontrate rezulton se puna e ngjashme nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit,si në zëra punimesh dhe në volume .Pra ne kete kontrate nuk ka zera punimesh të ngjashem referuar preventivit të procedures se prokurimit me objekt : **Rikonstruksion i linjes se ujesjellesit Kronjza - Rezervuaret Ujembledhes Leskovik, Bashkia Kolonje (faza e dyte) viti 2018** ,konkretisht :

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 140 mm, PN 16, t = 10.2 mm, **48 ml**

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 160 mm, PN 16, t = 11.8 mm, **738 ml**

F. v. bashkues (Reduksion PE 100,140/160) te tubit PE 100,DN = 140 mm,DN 160 mm **cope 1**

Kontrata e dorëzuar nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit .

3- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **SARK Shpk** referuar formularit të kontratës së paraqitur (pasi kontrata mungon) me objekt:

1.“Riparim mirembajtje nenkalimi Lumth”,

2.“ Riparim dhe mirembajtje rruga e Apit,fshati Rrapez”,

3.“ Riparim dhe mirembajtje me cakëll e rrugëve të fshatrave të komunë Kolonjë ”.

rezulton si mëposhtë :

Duke verifikuar zerat e punimeve sipas situacionit perfundimtar bashkengjitur formularit të kontratës rezulton se puna e ngjashme nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit,si në zëra punimesh dhe në volume .Pra ne keto objekte nuk ka zera punimesh të ngjashem referuar preventivit të procedures se prokurimit me objekt : **Rikonstruksion i linjes se ujesjellesit Kronjza - Rezervuaret Ujembledhes Leskovik, Bashkia Kolonje (faza e dyte) viti 2018** ,konkretisht :

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 140 mm, PN 16, t = 10.2 mm, **48 ml**

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 160 mm, PN 16, t = 11.8 mm, **738 ml**

F. v. bashkues (Reduksion PE 100,140/160) te tubit PE 100,DN = 140 mm,DN 160 mm **cope 1**

Puna e ngjashme e dorëzuar nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit .

4- Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **SARK Shpk** për

kontratën e paraqitur me objekt: “**Mirëmbajtje dhe Riparim i kanalit V-4**”,rezulton si mëposhtë :

Duke verifikuar zerat e punimeve sipas situacionit perfundimtar bashkengjitur kesaj kontrate rezulton se puna e ngjashme nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit,si në zëra punimesh dhe në volume .Pra ne kete kontrate nuk ka zera punimesh të ngjashem referuar preventivit të procedures se prokurimit me objekt : **Rikonstruksion i linjes se ujesjellesit Kronjza - Rezervuaret Ujembledhes Leskovik, Bashkia Kolonje (faza e dyte) viti 2018**,konkretisht :

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 140 mm, PN 16, t = 10.2 mm, **48 ml**

F .v. tubo e rakorderi ujesjellsi PE 100, DN = 160 mm, PN 16, t = 11.8 mm, **738 ml**

F. v. bashkues (Reduksion PE 100,140/160) te tubit PE 100,DN = 140 mm,DN 160 mm **cope 1**

Kontrata e dorëzuar nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik eshte konstatuar se nuk e plotëson kriterin 2.3.1 të dokumentave standarte të tenderit për punë të ngjashme.

c. Në kriteret e veçanta të kualifikimi kapacitetin teknik **pika 2.3.5**, ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej operatorëve ekonomik duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.

Kjo të vërtetohet me : Kontrate noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve,Diplomë,Librezë pune,CV,Urdher Mjeku,Të figurojnë në listëpagesën e shoqerise për 6 muajt e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **SARK Shpk** rezulton se kontrata e punës me mjekun **znj.Sofie Alushaj** nuk është lidhur përpara noterit,si dhe mungon librezja e punës kjo në kundërshtim me **kriterin 2.3.5** të dokumentave standarte të tenderit .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **SARK shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik EGLAND shpk me numer NUIS J 96829419 D

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Neni 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ **Për Prokurimin Publik** ”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **EGLAND shpk**.

a. Në kriteret e veçanta të kualifikimi kapacitetin teknik **pika 2.3.5**, ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, te pakten njeri prej operatorëve ekonomik duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje.

Kjo të vërtetohet me : Kontrate noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve,Diplomë,Librezë pune,CV,Urdher Mjeku,Të figurojnë në listëpagesën e shoqerise për 6

muajt e fundit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **EGLAND Shpk** rezulton se kontrata e punës me mjekun z. **Hazis Jella** nuk është lidhur përpara noterit, si dhe mungon librezja e punës kjo në kundërshtim me **kriterin 2.3.5** të dokumentave standarte të tenderit .

b. Në kriteret e veçanta të kualifikimi kapacitetin teknik **pika 2.3.6**, ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.6 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **25 punonjës** për periudhën **Janar 2017 – Maj 2018** (duke përfshirë edhe stafin tekniko menaxherial). Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Janar 2017 – Maj 2018**.

b) List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohe nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2017 – Maj 2018**, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **EGLAND Shpk** rezulton se mungon vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën **Maj 2018** dhe listëpagesat e punonjesve për periudhën **Maj 2018** , kjo në kundërshtim me **kriterin 2.3.6** të dokumentave standarte të tenderit .

c. Në kriteret e veçanta të kualifikimi kapacitetin teknik **pika 2.3.7**, ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.7 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë/në në staf punonjës të pajisur me **deshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme)**, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, për realizimin e zërave të veçanta të punimeve si më poshtë:

- | | |
|------------------------|------------|
| ➤ Specialist Ndertimi | 4 (kater) |
| ➤ Specialist Hidraulik | 4 (kater) |
| ➤ Manovrator | 4 (kater) |

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontrate e punes
- Karte Identiteti
- Libreza e punes
- Per manovratorët të paraqitet edhe deshmita e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të renda të ndërtimit dhe punimeve në tokë të lëshuar nga DPSHTRR dhe leja e drejtimit ku të disponohet kategoria C.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik **EGLAND Shpk** rezulton si mëposhtë :

Mungon dokumentacioni për 3 Specialist Ndertimi me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme)

Mungon dokumentacioni për 2 Specialist hidraulik me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme)

Dokumentacioni i dorëzuar nuk e plotëson **kriterin 2.3.7** të dokumentave standarte të tenderit .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1, nenit 53, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** ofertën e

operatorit ekonomik **EGLAND Shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ***bashkimin e operatoreve ekonomik Avdolli shpk, Vashtmia shpk dhe Rehovari shpk*** , me adresë: *Avdolli shpk Korçë, Korçë Lagjja Nr. 18, Rruga Muzakajt, Zona Kadastrale 8561, Nr. Pasurie 96 dhe Vashtemia Shpk Korçë, Libonik Vashtemi rruga nacionale Korçë –Pogradec Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6 dhe Rehovari shpk Korce Qender - Erseke REHOVE Ndertese nje kateshe, zona kadastrale 3164, numri i pasurise 630/134*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,300,000 (Dymilionetreqindmijë) lekë pa Tvsh**, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri	Bashkisë Kolonjë
Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vonë se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet në përputhje me nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **19.06.2018**

Ankesa: **Jo**

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIA STEFO